



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO  
 AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT  
 AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE  
 ANTI-CORRUPTION AGENCY

Dep. 2-D / DPK  
 Nr. l faq. 02  
 Broj stranica  
 Nr. pages

Nr. Prot. 01-1376/2012  
 Br. Prot. Prot No.  
 Data Datum  
 Date 17-04-2012

PRISHTINË



## Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT  
 AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE  
 ANTI - CORRUPTION AGENCY

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 29 paragrafi 1 pika e) të Rregullores së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë **29.03.2012**, nxjerr këtë:

### V E N D I M

**I. Mbyllet rasti me nr. AKK-03-4763/11, për z. Sami KURTESHI – Avokat i popullit, për shkak se është shmangur situata me konflikt interesi në të cilën ndodhej ky zyrtar i lartë publik.**

**II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.**

### A r s y e t i m

I. Rasti nr. AKK-03-4763/11 i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt Interesi në ushtrimin e funksionit publik, për Zyrtarin e lartë, Sami Kurteshi – Avokat i Popullit në Republikën e Kosovës, është trajtuar sipas procedurës së paraparë ligjore, të nevojshme për këtë situatë (Ligji Nr.04/L-051, Neni 18, pika 1).

Pas identifikimit të rastit me dyshimin e bazuar për ekzistimin e konfliktit të interesit, që shfaqej nga ushtrimi i dy funksioneve të papajtueshme, një si Avokat i Popullit, në njëren anë, dhe ushtrimi i funksionit drejtues të biznesit privat, N.t. "Luxury" sh.p.k, në anën tjetër, Zyrtarit të lartë i është bërë shkresa e parë njoftuese nga Agjencia Kundër Korrupsionit – AKK, me datën 27.02.2012 (Neni 18, paragrafi 5, Ligjit Nr.04/L-051).

Kësaj shkrese Zyrtari i Lartë, i është përgjigjur brenda afatit ligjor dhe në takim me zyrtarët e Agjencisë, ai është njoftuar për veprimet të cilat, ai në cilësinë e personit të Lartë Zyrtar duhet t'i ndërmerret, për të shmangur situatën e papajtueshme gjatë ushtrimit të funksionit publik dhe funksionit drejtues në ndërmarrjen private.

Zyrtari i Lartë, Sami Kurteshi, me datën 13.03.2012 në Agjencinë Kundër Korrupsionit ka sjell informatat mbi biznesin, ("Luxury" N.t.) të ndryshuara në të cilat shihet se zyrtari Kurteshi nuk

ushtron më funksion menaxhuese e as drejtues në ndërmarrjen e përmendur. Këto të drejta tani, sipas ligjit, janë bartur te personi i tij i besuar.

Kështu, me këto informacione zyrtare mbi biznesin, të lëshuara nga Agjensioni për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë, që janë sjellë në Agjencinë kundër Korrupsionit me një shkresë përcjellëse dhe kanë numër protokoli DPK/DPKI, 03-1004/2012, kemi konstatuar se është shmangur situata konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik, gjithnjë duke u bazuar në Ligjin për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në ushtrimin e funksionit publik (Nr.04/L-051).

**II.** Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./znj. (zyrtari kontaktues)

Drejtore i Agjencisë Kundër Korrupsionit

\_\_\_\_\_  
/ Hasan Preteni /

